dukshme te kerkesave ambientale punedhënesit dhe specialistit ,stafi specialist dhe per te monitoruar kerkesat ambientale dite pas dite.

5.2 Ngjeshje te panevojshme te dheut/terrenit

Do perdoret cdo orvatje per te evituar ngjeshje te panevojshme te terrenit Ne rastet kur ngjeshje te tille jane te paevitueshme p.,sh hyrje te perkohshme ne zona apo fusha , kontraktuesi merr te gjitha masat e nevojshme qe terreni te jete I lire per te gjithe thellesine e ngjeshjes para procesit te rigjallerimit.

5.3 Ndotjet e kanaleve ujore

Ndotjet e rrjedhjes ujit duhen evituar. Kontraktuesi duhet te kete nje axhende te punimeve afer vijes lundruese qe do jete rigorozisht ne stinen e thate.

5.4 Gjuetia etj.

Kontraktuesi duhet te ndaloje personelin te gjuaje peshk , te gjuaje ,vrase plagose apo hyrje pa leje ne faune.

5.5 Aksesit ne prona

Te gjitha hyrjet e pronave ekzistuese , rruget duhet te respektohen ne cdo moment te zbatimit te punimeve.

Kudo qe prona ka nje hyrje ekzistuese kontraktuesi duhet te siguroje permes disponibilitetit te punimeve te perkohshme adekuate qe kjo hyrje mbetet ne dispozicion te pronarit te prones gjate punimeve.

5.6 Takimet publike

Kontraktuesi gjen masat e nevojshme duke perfshire mbledhjet publike me qellim te garantoje qe publiku te jete vazhdimisht ne dijeni te programeve dhe asaj qe ndodh

Sigurohet qe se paku .qe nje anetar I personelit te tij eshte disponibel gjate orarit te punimeve per t'u perballur me kerkesat e publikut dhe reklamimet e tyre ne aktivitetin e tij.

5.7 Punonjesi i sigurise dhe shendetit mjedisor

Kontraktuesi eshte pergjegjes per mjedisin shendetin dhe Sigurine ne gjithe vendin e punes

Ai emerone nje nga bashkepunetoret e tij me kohe te plote si nje officer i sigurise dhe shendetit ne pune dhe sigurohet qe i gjithe personeli merr nje formim te pershtatshem.

6. DETAJE TEKNIKE

Periudha e zbatimit te projektit do te jete 5 muaj, periudha e mirembajtjes 1.5 vjet.

- Të gjithë llojet e bimësisë, drurët dhe shkurret që do të përdoren në gjelbërim, duhet të sillen pranë vendit ku do të implantohen (gropës) në vazo për siguri më të madhe në zënie. Vazo do të ketë perimenter minimumi 50 cm dhe të shkurreve 30 cm.
- Lartësia e kurorës së drurit (trung i vetëkrasitur) nga sipërfaqja e tokës dhe nga toka është e pjerrët, distanca nga niveli i rruges, pas implantimit të drurit, duhet të jetë minimumi 250 cm.
- Trungu deri në 250 cm duhet të jetë pa lastarizime, kurora e gjatë mund të jetë nga 150-250 cm.
- Lartësia totale e drurëve pas vendosjes në gropë (mbjelljes), duke parë edhe llojin e bimësisë, duhet të jetë nga 3.50 - 4 m nga niveli i tokës ose i rruges nëse vendosen në disnivel me rrugën.
- Trungu i vetëkrasitur i drurëve që do të përdoren në gjelbërim, duhet të jetë i pastër, pa plagë dhe me procese të kallusimit natyral të perfunduara.
- Pemët duhet të shoqërohen me çertifikatë fitosanitare.
- Pemët do të mbështeten me anë të ristelave të drurit, të vendosura në mënyrë trekëndore, sipas specifikimit.
- Shkurret që do të mbillen duhet të kenë 5-7 degezime
- Gropat do të jenë të përmasave 80x80x80 cm për mbjelljen e pemëve.
- Madhësia e gropës për implantimin e shkurreve duhet të jetë 40 X 40 X 40 cm.
- Dheu me të cilin do të mbushen gropat, duhet të përmbajë pleh organik në sasinë 16-20 kg/grope për druret dhe 10 kg/grope për shkurret.
- Përveç plehut organik, është parashikuar dhe hedhja e plehut kimik.
- Pas mbjelljes së pemëve dhe shkurreve, kryhet mbjellja e barit me anë të teknologjisë së Hidrombjelljes me trashësi të shtuar (me varietete barësh graminore të cilat respektojnë varietetet autoktone barishtore) dhe me stolone të copezuara.
- Të gjitha bimët (drure, shkurre dhe fara) duhet të shoqërohen me certifikatën e origjinës dhe cilësive dhe pastërtisë varietore, si dhe duhet të certifikohen në vend nga një organ certifikues i akredituar i farave dhe fidaneve, përpara se të kryhet mbjellja e tyre.
- Për piketimin e vendeve të mbjelljes duhet angazhuar një topograf.
- Të gjitha bimët që do të mbillen duhet të jenë tre javë përpara të magazinuara në objektin mbështetës (fidanishte) për certifikimin e tyre dhe të njostohet autoriteti kontraktor.

Detaje teknike për kryerjen e punimeve të gjelbërimit dhe mirëmbajtjes gjatë periudhës së mirëmbajtjes dhe garancisë



- Perpara se te realizohet pergatitja e terrenit per mbjelljet e reja, duhet te kryhet pastrimi i skarpatave dhe siperfaqeve qe do te gjelberohen, nga mbetjet dhe inertet.
- Degezat e rena ne terren te pemeve si edhe shkurret e shkulura nga terrenet e percaktuara per t'u gjelberuar duhen prere me makineri korrese.
- Terrenet e gjelberuara duhet te korren te pakten 2 here ne muaj ne periudhen pranvere-vjeshte si edhe te pakten 1-2 here ne muaj ne periudhen vere dhe dimer (ne total 60 kositje).
- Gjethet e rena ne terren dhe anes rruges se pemeve duhen larguar.
- Fidanet dhe shkurret jane parashikuar te ujitin 60 here gjate periudhes se mirembajtjes, ne periudhen e vegjetacionit (Prill-Nentor).

Llojet e bimeve sipas projektit:

Lloji i drurit dhe Permasat (cm), c- cirkumferenca, h-lartesia

Cirkumferenca e matur 1 m nga baza e tokes


Druret dhe shkurret qe do te mbillen jane:

Platanus orientalis c.18-20 cm
Celtis australis c.18-20 cm
Carpinus betulus c.18-20 cm
Prunus pissardi c.18-20 cm
Fraxinus excelsior c.18-20 cm
Cercis silquastrum c. 18-20 cm
Liquidambar styraciflua c.18-20 cm
Acer campestre c.18-20 cm
Tilia c.18-20 cm
Crataegus laevigata c.18-20 cm
Nerium oleander 100-120 cm
Juniperus spp. v18
Robinia pseudoaccacia 1-2 vjecare

Per te gjitha druret ne total, te kihet parasysh qe te kete shperndarje uniforme te perimetrit

(Cirkumferences), dmth ne cirkumferencen 18-20 cm, 33.3 % te jene me cirkumference 18 cm, 33.3 % te jene 19 cm dhe 33.3% te jene 20 cm.

Për vendosjen e pemëve do të zbatohet menyra e mëposhtme:



HIDROMBJELLJA

Hidrombjellja është një teknikë për mbjelljen e barit në skarpata apo terrene të sheshta. Quhet ndryshe dhe hydromulch. Procesi i hidrombjelljes përfshin spërkatjen e tokës me një përzierje farash, plehu dhe uji, si dhe fibre celuloze. Shtohen dhe agjentë të tjerë, si gëlqere, për të trajtuar tokën përpara spërkatjes me zorrë. Kur përzierja spërkatet në tokë,

Albanian Development Fund



27
GREEN FARM Sh.p.k
NIPT: K7/V/7401 G
LUSHAJE

lagështia krijon një mburojë për farat duke i lejuar ato të gjermojnë.

Materialet të cilat përbëjnë këtë përzierje që do të spërkatet duhet të jenë të tëra me bazë natyrale dhe të jenë të shpërbëshme në mënyrë bio, për të patur një ndikim sa më të vogël në ambientin rrethues. Prejardhja dhe fuqia mbirëse e farërave duhet të jetë e certifikuar dhe përzierja e tyre me materialet e tjera duhet të kryhet në vendin e aplikimit në mënyrë që të parandalohet shtresëzimi i farërave brenda depozitës sperkatëse.

Kjo lloj teknike Hidrombjellje parashikon përdorimin e përbërësve të mëposhtem:

- Përzierje farërash bari të përshtatshme (Graminore dhe leguminose) me doza përdorimi të ndryshme duke filluar nga 35 gr/m² deri në 65 gr/m² në situata të vecanta.
- Shtesë varieteti special i Cynodon dactylon “Yukon” në stolone të copezuara në sasi 20 gr/m²
- Plehërim bazë me produkte organiko- minerale të barazpeshuar dhe me mikroelemente, me doza përdorimi në kushte normale prej 15 gr/m²; është e domosdoshme gjithashtu një analizë paraprake e terrenit për ti përshtatur plehërimin nevojave reale si dhe për të korrigjuar nëse duhet pH e mangësitë në minerale.
- Materiale organike: Torfe bjonde dhe të zezë, me pH të korrigjuar në sasi jo më pak se 400 ml/m² është e domosdoshme për të siguruar nevojat për materiale organike.
- Një shtesë mbrojtëse MULCH me bazë celuloze në sasi prej 300 gr/m²
- Ngjitës me përbërje natyrale në sasi prej 0.008 gr/m²
- Fitohormone shtesë (3 ÷ 5 gr/m²)

Spërkatja e përzierjes mbi skarpatat duhet të kryhet me anë të një makinerie për Hidrombjellje e cila duhet të jetë e pajisur me një përzierës mekanik dhe e afte të përziejë dhe të spërkatë përveç përzierjes së zakonshme të materialeve të hidrombjelljes, edhe stolone të copëzuara, si edhe të sigurojë një përzierje të vazhdueshme dhe të plotë të përbërësve si edhe me tuba të zgjatshëm në mënyrë që të ketë mundësi të afrohet gryka hedhëse e makinerisë së Hidrombjelljes në largësinë më të mirë të mundshme për të spërkatur përzierjen.

Aplikimi i përzierjes duhet të kryhet me të paktën dy spërkatje:

- Spërkatja e parë me farën, fitohormonet, 300 ml/m² torfë, 150 gr/m² Mulch, 0.005 gr/m² ngjitës.
- Pasi të jetë tharë shtresa e parë e spërkatur, kryhet spërkatja e dytë me torfën e mbetur, me Mulch e mbetur, dhe ngjitësin e mbetur.
- Përbërësit e përzierjes si dhe sasi të për metër katror përcaktohen në përputhje me kushtet e mjedisit rrethues, mikroklimës, kërkesës për gjelbërimin si dhe të përbërjes gjeomorfologjike të tokës.

KUJDESI MBI SIPERFAQEN, DRURET DHE SHKURRET

Transportimi, shtratifikimi dhe përgatitja për mbjellje

Gjatë transportimit të fidanëve nga fidanishtja deri në objektin ku do të mbillen, është e rëndësishme që ato të mbrohen për të mos u demtuar (ku mund të thuhet) sistemi rrënjor e veçanërisht qimet thithëse të tyre. Për këtë, duhet pasur parasysh që fidanet të jenë në vazo (plastike). Të gjithë llojet e bimësisë, drurët dhe shkurret që do të përdoren në gjelberim, duhet të sillen pranë vendit ku do të implantohen (gropës) në vazo për siguri më të madhe në zënie.

Gjatë transportimit të tyre nuk duhet lejuar ulja mbi fidanë ose vendosja e çfarëdo peshe mbi to.

MBJELLJA E FIDANEVE

Te gjitha kostot e blerjes, transportit dhe mbjelljes se pemeve jane te perfshira ne cmimin e pemeve

Piketimi ,hapja e gropes

Pasi ka përfunduar punimi i përgjithshëm i tokës, caktohen vendet se ku do të mbillen drurët dhe shkurret dekorative, sipas projektit teknik.

Ky vend caktohet duke vendosur në tokë piketa të etiketuara sipas llojeve të fidanëve. Madhësia e gropave është e ndryshme për drurët dhe për shkurret. Ajo varet prej përbërjes së tokës, moshës së fidanit dhe madhësisë e shtrirjes së vetë sistemit rrënjor të tyre. Dy-tre vjet mbas mbjelljes, fidanët kërkojnë tokë më të shkrifët dhe më pjellore me qëllim që të zhvillojnë më mirë sistemin e tyre rrënjor.

Mbjellja

Mbjellja e fidanit duhet të bëhet prej dy punëtorëve.

Në gropën ku është mbjellë fidani, dheu duhet të qëndrojë 3-5 cm më lart se sa niveli i territorit, me qëllim që mbas cedimit të tij të fitohet niveli i mëparshëm.

KUJDESI PAS MBJELLJES (sherbime agroteknike)

Shkriftimi i Tokes

3 herë në vit (në pranverë, në verë dhe në vjeshtë), duhet t'u bëhet punimi dhe shkrifërimi



i tokës përreth trungut. Ky punim zakonisht kryhet me bel ose me shat, dhe është i nevojshëm sidomos vitin e parë mbas mbjelljes. Duhet që ky proces të kryhet mbasi të kenë kaluar ngricat e pranverës.

Ujitja

Sasia e ujit që duhet përdor për vadije përcaktohet edhe nga lloji dhe përbërja e tokës, por ne përgjithësi përdoret 30 l uje nje dru i rritur dhe 3-4 l nje shkurre.

SIPERFAQJA E BARIT

Cilesite

- a) të mos mbajë ujin e shiut. Kjo sigurohet nëpërmjet përmirësimit të tokës dhe drenazhimit të saj
- b) të jetë e fortë që të mos deformohet gjatë shkeljeve
- c) të ripërtërihet shpejt pas kositjes

Roli i siperfaqes

Përveç rolit higjeno-sanitar, estetik, mjedisor, këto siperfaqe (shirita) shërbejnë edhe për ajrimin e tokës së parcelave dhe ndihmojnë në zhvillimin normal të drurëve dhe shkurreve dekorative.

Sipërfaqe bari në skarpate të pjerresive duhet t'u kushtohet vëmendje e duhur për të pasur densitetin e duhur dhe punimet paraprake të jenë bërë me shumë cilësi (dheu, ngjeshja, etj) në mënyrë që mos të ndodhë "cedimi i siperfaqes" apo zhvendosje.

Keto detaje dhe parametra teknike duhet të ruhen në zbatimin me sukses të këtij projekti .

7. MASAT DHE PAGESA

Pagesa për përmbushjen nga ana e kontraktorit të këtij seksioni (mbjellja e pemeve) do të mbulohet nga pagesa e kontraktorit të parashikuar në preventiv. Pagesa do të mbahet pjesërisht ose plotësisht në rast mosperputhjeje me këto kritere.

RAPORT TEKNIK

**Rehabilitimi i Gjelbërimit Anësor dhe
Hyrje-Daljeve në Qendrat e Banuara në
Segmentin Levan – Kakavijë**



PËRMBAJTJA

RAPORT TEKNIK	1
<i>TË PËRGJITHSHME</i>	3
1. HYRJE 3	
2. OBJEKTIVAT E PROJEKTIT.....	4
3. TERMAT TEKNIKE TË PROJEKTIT.....	4
4. SEGMENTI I: LEVAN - DAMËS	5
<i>PAMJE E GJENDJES AKTUALE</i>	6
<i>4.1. KARAKTERISTIKAT E KËTIJ SEGMENTI</i>	8
<i>4.1.1 SKEMA TEKNIKE E MBJELLJEVE DHE KRIJIMIT TË DEKORIT GJELBËRUES</i>	8
5. SEGMENTI II: DAMËS - TEPELENË	11
<i>5.1 KARAKTERISTIKAT E KËTIJ SEGMENTI</i>	13
<i>5.1.1 SKEMA TEKNIKE E MBJELLJEVE DHE KRIJIMIT TË DEKORIT GJELBËRUES</i>	13
6. SEGMENTI III: TEPELENË - GJIROKASTËR	16
<i>6.1 KARAKTERISTIKAT E KËTIJ SEGMENTI</i>	18
<i>6.2. SKEMA TEKNIKE E MBJELLJEVE, PLANIFIKIMI TEKNIK I GJELBËRIMIT TË SEGMENTIT DHE KRIJIMI I DEKORIT GJELBËRUES</i>	29
7. SEGMENTI POSTOBLI.OK-VARREZAT E QYTETIT, GJIROKASTER, 1.3 KM.....	30
8. SEGMENTI IV: GJIROKASTËR- KAKAVIJË.....	35
<i>8.1 KARAKTERISTIKAT E KËTIJ SEGMENTI</i>	37
<i>8.1.1. SKEMA TEKNIKE E MBJELLJEVE, PLANIFIKIMI TEKNIK I GJELBËRIMIT TË SEGMENTIT DHE KRIJIMI I DEKORIT GJELBËRUES</i>	48
10. PROJEKT PYLLEZIMI, TEPELENE.....	52
TE DHENA KRYESORE PER OBJEKTIN QE DO TE PYLLEZOHE	52
ADMINISTRIMI, LARGËSIA NGA QËNDRAT E BANUARA DHE LIDHJA ME RRUGËN AUTO	52
METODA E PËRDORUR PËR ZGJEDHJEN E LLOJEVE.....	53
MËNYRAT E KRYERJES SË PUNIMEVE TË PYLLEZIMIT	54
MËNYRAT E PYLLEZIMIT QË DO TË PËRDOREN	54
MËNYRAT E PUNIMIT TE TOKËS	54
SKEMA E MBJELLJES	55
KOHA DHE MËNYRA E MBJELLJES NË OBJEKTET E PYLLEZIMIT	56
SHERBIMET QË DO TË KRYHEN PAS PYLLEZIMIT	56
ZËNIE E SUKSESSHME E PYLLEZIMEVE	56
MONITORIMI PER ZENIEN E FIDANEVE	56
ZEVENDËSIMI I FIDANEVE.....	56

DREITORIA RAJONALE E SHËRBIMIT PYJOR GJIROKASTËR

MASAT MBROJTËSE	57
Permbledhese e punimeve per objektin (pyllezime + sherbime kulturele);	57
10. DETAJE TEKNIKE PER ZBATIMIN E PROJEKTIT	57


Të përgjithshme

Segmenti rrugor, Levan – Kakavijë, është një nga arteriet kryesore të qarkullimit të automjeteve me drejtim pikën kufitare të Kakavijës. Cilësohet dhe është një nga aksat më të rëndësishëm në çdo aspekt për zhvillimin turistik e ekonomik të vendit. Ky aks që njihet si aksi i Jugut, mund të themi pa asnjë dyshim, është aksi më i rëndësishëm rrugor i vendit, me impakt të jashtëzakonshëm në zhvillimin e gjithë pjesës jugore të vendit dhe për pasojë edhe për ekonominë tonë kombëtare, pasi kjo zonë për nga zhvillimi dhe potenciali ekonomik është kontribuesi më i rëndësishëm në ekonominë e vendit.

Hapësirat e gjelbërta në zonat apo rrugët urbane e interurbane kryesore, si dhe përgjatë kategorive të tjera të rrugëve janë mjaft të rëndësishme jo vetëm në lidhje me përmirësimin e peisazhit të zonave në të cilat aplikohet gjelbërimi, por edhe në uljen e ndotjes së ajrit të krijuar nga ngarkesa e lartë e vërejtur e trafikut. Për më tepër shërben shpesh edhe si pengesë ekologjike për të mos lejuar lëvizjen e këmbësorëve nga njëri krah në tjetrin të rrugëve interurbane dhe duke bërë të mundur rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për të respektuar rregullat e qarkullimit rrugor dhe mbrojtjen e ambientit rrethues. Në këtë aks për fat të keq vërehet një mungesë e theksuar e gjelbërimit, si e atij të ulët (shkurre) apo edhe atij të lartë (pemë).

1. Hyrje

Rehabilitimi i gjelbërimit me anë të mbjelljes së bimëve të larta dhe të ulta, në të gjitha ato hapësira të lira ku është e mundur, e vendqëndrimeve të përkohshme të automjeteve si edhe të hyrje- daljeve në qendrat e banuara përgjatë këtij segmenti rrugor, do të bënte më të këndshëm dhe tërheqës udhëtimin drejt pikës kufitare apo edhe në drejtim të kundërt. Një projekt rehabilitues i gjelbërimit me përmasa të tilla, për shtimin e sipërfaqeve të gjelbëruara interurbane, do të japë një tjetër imazh për vendin tonë.



2. Objektivat e Projektit

- 1) Të shtojë masën e kurorës së gjelbërt, të realizojë e të krijojë hijëzím, sa më tepër që të jetë e mundur, përgjatë segmentit Levan – Kakavijë.
- 2) Të maskojë sa më tepër të jetë e mundur me gjelbërim të lartë apo të ulët, peisazhet jo të këndshme të krijuara nga ndërtimet apo mbetjet inerte përgjatë këtij segmenti.
- 3) Të krijohen mundësi të zhvillimit të përshtatshëm të bimësisë si në zonat e mundshme për tu gjelbëruar, ashtu edhe në pjesët trafikndarëse apo vendqëndrimet me ishuj në këtë segment rrugor.
- 4) Të krijojë mundësi të reja punësimi dhe të prodhojë të ardhura shtesë për ekonominë përgjatë segmentit, gjatë dhe pas përfundimit të projektit.

3. Termat teknike të projektit

Segmenti Levan – Kakavijë, ka një gjatësi të përgjithshme prej 128.775 m. Shtrirja e këtij segmenti në gjatësinë e tij është në terren fushor dhe malor. Gjelbërimi anësor, i hyrje-daljeve në qendrat e banuara si edhe i vendqëndrimeve me ishuj të këtij aksi është menduar të preventivohet dhe kryhet i ndarë në segmente, të cilat edhe nga pikëpamja e koncept-idesë së sistemimit të hapësirave të gjelbëra do të jenë ndryshe nga njëri-tjetri.

Kjo bëhet duke marrë parasysh shirirjen, pozitën gjeografike por edhe për specifika të tjera si të infrastrukturës, llojit të ekonomive të zonës, dhe mbi të gjitha të hapësirave të përshtatshme e të mundshme për gjelbërim.

Segmenti i parë Levan - Damës. Ky segment ka një gjatësi totale prej 38.675 m.


Segmenti i dytë Damës – Tepelenë. Ky segment ka një gjatësi prej 32.435 m.

Segmenti i tretë Tepelenë – Gjirokastër. Ky segment ka një gjatësi prej 28.700 m.

Segmenti i katërt Gjirokastër – Kakavijë. Ky segment ka një gjatësi prej 28.965 m.

4. Segmenti I: Levan - Damës

Ky segment ruge është pjesë e aksit Levan - Kakavijë. Është projektuar dhe ndërtuar me 2 korsi (1 në vajtje dhe 1 në ardhje) të pandara me trafik-ndarës.



5
GREEN FARM Sh.p.k
NIPT: K74727401 G
LUSHNJE




Panorje e gjendjes aktuale

Relievi - Në segmentin Levan-Damës mbizotëron relievi fushor ku edhe relievet kodrinore janë përgjithësisht të buta.


Klima - Segmenti Levan-Damës përfshihet në zonën e klimës mesdhetare fushore, e cila karakterizohet nga vera e nxehë dhe e thatë dhe dimri i butë dhe me rreshje të mëdha. Kjo zonë është e mbrojtur nga lëndja prej erërave të flohta dhe dallohet për numrin e lartë të ditëve me diell, mesatarisht 2800 orë në vit. Rreshjet kanë regjim kohor shumë të çrregullt. Ato janë përqendruar kryesisht në gjysmën e ftohtë të vitit, sasia mesatare e tyre arrin 980-1000 mm/vit. Erërat fryjnë në drejtime të ndryshme por gjatë dimrit mbizotëron era e jugut, e cila sjell edhe rreshje të mëdha, ndërsa gjatë verës era fryn nga veriu dhe veri-perëndimi. Temperatura mesatare vjetore lëkundet nga 15°C-16°C.

GRAFIKU I TEMPERATURAVE



Grafiku tregon temperaturën mesatare mujore. Vija e kuqe tregon mesataren e temperaturës maksimale, ndërsa vija blu temperaturën minimale mesatare. Të dhënat janë bazuar në matjet gjatë dhjetë viteve të fundit.

GRAFIKU I RRESHJEVE



Lartësia e kolonës blu tregon numrin e ditëve me shi në muaj. Të dhënat janë bazuar në matjet gjatë dhjetë viteve të fundit.

Përberja e tokës - Litologjia e kësaj zone më së shumti përfaqësohet nga tokat argjilore të papërshkueshme.




DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT PYJOR GJIROKASTËR

Bimësia - Segmenti Levan-Damës bën pjesë në brezin e shkurreve dhe të katit të dushkut. Shkurret përbëhen nga nënkati i makies, ku rriten shkurret me gjelbërim të përhershëm si mareja, shqopa, gjineshtra, dafina.

4.1. Karakteristikat e këtij segmenti

Ky segment ka një gjatësi prej 38.675 ml. Gjerësia e korsive është 3.8 m dhe bankinë 1.5 m. Hapësirat për të implementuar gjelbërimin e lartë shkojnë në një gjerësi deri në 6.5 m në krah të autostradës. Këtu kemi mundësi zhvillimi të gjelbërimit të lartë duke e shtrirë përgjatë gjithë gjatësisë në të dy krahët e rrugës me 10 lloje të ndryshme pemësh.



Skema 4.1.1. Seksiom tërthor i gjendjes aktuale

4.1.1 Skema teknike e mbjelljeve dhe krijimit të dekorit gjelbërues

Gjatësia për gjelbërim me bimë drusore përgjatë rrugës është 26.850 ml majtas dhe 29.640 ml djathtas, 56.490 ml në total.


Punimet për gjelbërimin e këtij aksi do të realizohen në:

1. Sjellja dhe shpërndarja e 8474 m³ terren vegjetal për të veshur skarpatat, bankinat dhe mbeturinat e krijuara nga materialet inerte pas ndërtimit të rrugës, të kryhet nivelimi me makineri të posacme të drejtura me lazer, dhe mbjellja me bimësi drunore me distancë 30 ml nga aksi në aks.
 - a. Në pjesën e bankinave dhe skarpatave gjelbërimi do të kryhet nga 10 lloje drurësh: *Platanus orientalis* c. 18-20 cm, *Celtis australis* c. 18-20 cm, *Carpinus betulus* c. 18-20 cm, *Prunus pissardi* c. 18-20 cm, *Fraxinus excelsior* c. 18-20 cm, *Cercis silquastrum* c. 18-20 cm, *Crataegus laevigata* c. 18-20 cm, *Liquidambar styraciflua* c. 18-20 cm, *Acer campestre* c. 18-20 cm, *Tilia* c. 18-20 cm. Gjatësia totale ku do të realizohet gjelbërimi me bimë drusore është 26.850 ml në krahun e majtë + 29.640 ml në krahun e djathtë = 56.490 ml.

DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT PYJOR GJIROKASTËR


- b. Llojet drunore do të jenë të vendosura me një largësi prej 30 m nga njëra-tjetra nga aksi në aks, çfarë përkon dhe me distancën e nevojshme për shpejtësinë e lëvizjes maksimale prej 90 km/orë në këtë segment.

Te skema 4.1.2 paraqitet nëpërmjet seksionit tërthor se ku do të vendosen bimët Drusore dhe distancat në raport me rrugën.



Skema 4.1.2 Seksioni tërthor i propozuar

Te skema 4.1.3 paraqitet nëpërmjet fragmentit në planimetri se ku do të vendosen bimët Drusore dhe distancat në raport me rrugën.



Skema 4.1.3 Fragmenti nga propozimi në Planimetri


4.1.2 Krijimi i "Detyrës Vizuale" përfundimtare



DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT PYJOR GJIROKASTËR

Gërshetimi i elementëve të gjelbërimit që trajtuam më sipër për rehabilitimin e këtij segmenti, do të krijonte një pamje si më poshtë.

Ndërkaq edhe pamjet 3 dimensionale të këtij segmenti kanë një efekt viziv për të na paraqitur më së miri situatën reale që do të ndodhë në atë që është parashikuar duke krijuar pamje imagjinare me sensin e lëvizjes, dhe me llojshmërinë e bimësisë.



Pamje e Segmentit Levan-Damës pas rehabilitimit

5. Segmenti II: Damës - Tepelenë

Ky segment rruge është pjesë e aksit rrugor Levan - Kakavijë. Është projektuar dhe ndërtuar me 2 kors (1 në vajje dhe 1 në ardhje) të pandara me trafik-ndarës.




Panorje e gjendjes aktuale

Relievi - Në segmentin Damës-Tepelenë mbizotëron përgjithësisht relievi kodrinoro-malor, ku segmenti Memaliaj-Tepelenë përfshihet në zonën paramalore.




DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT PYJOR GJIROKASTËR

Klima – Segmenti Damës-Tepelenë ndodhet në zonën e klimës mesdhetare kodrinore dhe mesdhetare paramalore. Klima mesdhetare kodrinore dallohet për dimër të butë e të lagësht dhe verë të nxehtë e të thatë. Temperatura mesatare vjetore është 15.3 gradë celsius, ndërsa mesatarja vjetore e rreshjeve është 1426 mm. Klima mesdhetare paramalore dallohet për dimër më të ashpër dhe verë disi më të freskët. Temperatura mesatare vjetore luhatet në 15 gradë celsius, ndërsa mesatarja vjetore e rreshjeve luhatet midis 1000-2000 mm.



Grafiku tregon temperaturën mesatare mujore. Vija e kuqe tregon mesataren e temperaturës maksimale, ndërsa vija blu temperaturën minimale mesatare. Të dhënat janë bazuar në matjet gjatë dhjetë viteve të fundit.




Lartësia e kolonës blu tregon numrin e ditëve me shi në muaj. Të dhënat janë bazuar në matjet gjatë dhjetë viteve të fundit.

Përbërja e tokës - Litologjia e kësaj zone më së shumti përfaqësohet nga gëlqerorët, të cilat herë shfaqen pllakë e herë masive kompakte.

Bimësia – Segmenti Damës-Tepelenë bën pjesë në brezin e shkurreve dhe në katin e dushikut. Shkurret përbëhen nga nënkati i makies, ku rriten shkurret me gjelbërim të përhershëm si marea, shqopa, gjineshtra, daftina.

5.1 Karakteristikat e këtij segmenti

Ky segment ka një gjatësi prej 32.435 ml. Gjerësia e korsive është 3.8 m dhe bankinë 1.5 m. Hapësirat për të implementuar gjelberimin e lartë shkojnë në një gjerësi deri në 6.6 m në krah të autostradës. Këtu kemi mundësi zhvillimi të gjelbërimit të lartë duke e shtrirë përgjatë gjithë gjatësisë në të dy krahët e rrugës me 10 lloje të ndryshme pemësh. Seksioni tërthor na tregon gjendjen aktuale.



Skema 6.1.1. Seksioni tërthor i gjendjes aktuale

Tipologjia e rehabilitimit në këtë segment është rehabilitimi dhe mbjellja e skarpatave dhe bankinave.


5.1.1 Skema teknike e mbjelljeve dhe krijimit të dekorit gjelbërues

Gjatësia për gjelbërim përgjatë rrugës është 15.540 ml majtas dhe 16.290 ml djathtas, 31.830 ml në total. Punimet për gjelbërimin e këtij aksi do të realizohen në **Rehabilitimin dhe mbjelljen e skarpatave dhe bankinave me bimë drusore**. Është e nevojshme sjellja dhe shpërndarja e 272 m³ terren vegjetal për të veshur skarpatat, bankinat dhe mbeturinat e krijuara nga materialet inerte pas ndërtimit të rrugës.

- Në pjesën e bankinave dhe skarpatave gjelbërimi do të kryhet nga 10 lloje drurësh: *Platanus orientalis* c. 18-20 cm, *Celtis australis* c. 18-20 cm, *Carpinus betulus* c. 18-20 cm, *Prunus pissardi* c. 18-20 cm, *Fraxinus excelsior* c. 18-20 cm, *Cercis siliquastrum* c. 18-20 cm, *Liquidambar styraciflua* c. 18-20 cm, *Acer campestre* c. 18-20 cm, *Tilia* c. 18-20 cm. Gjatësia totale ku do të realizohet gjelbërimi është 15.540 ml në krahun e majtë + 16.290 ml në krahun e djathtë = 21.830 ml.
- Llojet drunore do të jenë të vendosura me një largësi prej 30 m nga njëra-tjetra nga aksi në aks, çfarë përkon dhe me distancën e nevojshme për shpejtësinë e lëvizjes maksimale prej 90 km/orë në këtë segment.




Te skema 6.1.2 paraqitet nëpërmjet seksionit tërthor se ku do të vendosen bimët Drusore dhe distancat në raport me rrugën.



Skema 6.1.2. Seksioni tërthor i propozuar

Te skema 6.1.3 paraqitet nëpërmjet fragmentit në planimetri se ku do të vendosen bimët Drusore dhe distancat në raport me rrugën.



Skema 6.1.3 Fragmenti në planimetri i propozuar

5.1.2 Krijimi i "Dizenjos Vizuale" përfundimtare

Gërshetimi i elementëve të gjelbërimit që trajtuam më sipër, drurë dhe sipërfaqe barishtore, për rehabilitimin e këtij segmenti, do të krijonte një pamje si më poshtë.

DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT PYJOR GIROKASTËR

Ndërkaq edhe pamjet 3 dimensionale të këtij segmenti kanë një efekt viziv për të na paraqitur më së miri situatën reale që do të ndodhë në atë që është parashikuar duke krijuar pamje imagjinare me sensin e lëvizjes, dhe me llojshmërinë e bimësisë.



Pamje e Segmentit Damës-Tepelenë pas rehabilitimit



15
GREEN FARM Sh.p.k
NIPT: K74727401 G
LUSHNJË

6. Segmenti III: Tepelenë - Gjirokastër

Ky segment rruge është pjesë e aksit rrugor Levan - Kakavijë. Është projektuar dhe ndërtuar me 2 korsi (1 në vajtje dhe 1 në ardhje) të pandara me trafik-ndarës.




Pamje e gjendjes ekzistuese

DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT PYJOR GJIROKASTËR

Relievi - Në segmentin Tepelenë-Gjirokastrë mbizotëron relievi kodrinoro-malor. Lartësia mesatare mbi nivelin e detit është 732 m.

Klima - Segmenti Tepelenë-Gjirokastrë ndodhet në zonën e klimës mesdhetare kodrinore dhe paramalore. Klima mesdhetare kodrinore dallohet për dimër të butë e të lagësht dhe verë të nxehtë e të thatë. Temperatura mesatare vjetore është 15.3 gradë celsius, ndërsa mesatarja vjetore e rreshjeve është 1426 mm. Klima mesdhetare paramalore dallohet për dimër më të ashpër dhe verë disi më të freskët. Temperatura mesatare vjetore luhet në 15 gradë celsius, ndërsa mesatarja vjetore e rreshjeve luhet midis 1000-2000 mm.



Grafiku tregon temperaturën mesatare mujore. Vija e kuqe tregon mesataren e temperaturës maksimale, ndërsa vija blu temperaturën minimale mesatare. Të dhënat janë bazuar në matjet gjatë dhjetë viteve të fundit



Lartësia e kolonës blu tregon numrin e ditëve me shi në muaj. Të dhënat janë bazuar në matjet gjatë dhjetë viteve të fundit.

Përbërja e tokës - Litologjia e kesaj zone më së shumti përfaqësohet nga gëlqerorët, të cilat herë shfaqen pllakë e herë masive kompakte. Sizmika në rreth është tepër aktive. Fuqia sizmike e hasur në 1920 ka arritur në magnitudë 5.8 dhe intensitet 9 ballë.



DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT PYJOR GJIROKASTËR

Bimësia – Segmenti Tepelenë-Gjirokastër shtrihet në një zonë të pasur me bimësi, si në lloje ashtu dhe në shtrirje. Në të ndeshen nga brezi i shkurreve, që shtrihet deri në lartësinë 600-800 metra, brezi i dushkut 800-1200 metra, pyjet fletëgjerë, halore e të perzier dhe deri në kullotat alpine me lartësi mbi 1000 m.

6.1 Karakteristikat e këtij segmenti

Ky segment ka një gjatësi prej 28.700 m. Gjerësia e korsive është 3.75 m dhe bankinë 1.5 m. Hapësirat për të implementuar gjelberimin e lartë shkojnë në një gjerësi deri në 5.3 m në krah të autostradës. Këtu kemi mundësi zhvillimi të gjelbërimit të lartë duke e shtrirë përgjatë gjithë gjatësisë në të dy krahët e rrugës me 10 lloje të ndryshme pemësh. Seksioni tërthor na tregon gjendjen aktuale.

Skema 8.1.1. Seksioni tërthor i gjendjes aktuale

Punimet për gjelbërimit të këtij aksi do të realizohen në **Rehabilitimin dhe mbjelljen e skarpatave dhe bankinave me bimë drusore**. Është e nevojshme sjellja dhe shpërndarja e 261 m³ terren vegjetal për të veshur skarpatat, bankinat dhe mbeturinat e krijuara nga materialet inerte pas ndërtimit të rrugës.

- a. Për të krijuar më mirë imazhin e gjelbërimit, për të lehtësuar punën, kryer preventivimin e punimeve dhe për të llogaritur kostot përfundimtare që duhen për të gjelbëruar këtë segment do të përdoren renderat e rehabilitimit. Në të njëjtën kohë ajo shërben për të orientuar saktë sipërmarrësit e punimeve për të kryer punime të sakta dhe për të arritur versionin përfundimtar të gjelbërimit. Në planimetritë progresive të segmentit nuk janë paraqitur zonat nga km.0+000 – 0+900 dhe 25+900 – 28+700 ku nuk do të ndërhyet me gjelbërim.
- b. Llojet drunore do të jenë të vendosura me një largësi prej 30 m nga njëra-tjetra nga aksi në aks, çfarë përkon dhe me distancën e nevojshme për shpejtësinë e lëvizjes maksimale prej 90 km/orë në këtë segment.

1. **Rehabilitimin e gjelbërimit të vendqëndrimeve të përkohshme me ishuj të segmentit rrugor Tepelenë-Gjirokastër (Km.14+700-14+925; km.19+525-19+750)**

DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT PYJOR GIROKASTËR

Kjo tipologji ka një sipërfaqe totale për të gjelbëruar prej 220 m². Këtu kemi mundësi zhvillimi të gjelbërimit të ulët. Është e nevojshme sjellja dhe shpërndarja e 47 m³ terren vegjetal për sipërfaqet me terren të varfër.

2. Rehabilitimin e gjelbërimit në Hyrje-Daljet e qendrave të banuara

Në hyrje-daljet e qendrave të banuara të këtij segmenti ka mundësi të zhvillohet gjelbërimi i ulët me anë të hidrombjelljes. Gjelbërimi do të realizohet në hyrje-daljet e specifikuara si më poshtë:

a. Rrethrotullimi Hyrje Tepelenë - km. 0+000

Kjo pjesë ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 230 m². Këtu parashikohet të kryhet hidrombjellja me trashësi të shtuar, mbjellje shkurresh tipi Juniperus spp.me lartësi 18 cm, 9 cope/m², sipas skemes së paraqitur më poshtë:

Foto te gjendjes ekzistuese



Planimetria



b. Rrethrotullimi Dalje Tepelenë - km. 0+950

Kjo pjesë ka një sipërfaqe për t'u gjelbëruar me ane të hidrombjelljes prej 30 m².



Foto te gjendjes ekzistuese



c. Dalje Luzat - km. 4+350


Gjendja ekzistuese

Vendndodhja




Foto te gjendjes ekzistuese





Kjo pjesë ka një sipërfaqe totale për t'u gjelbëruar prej 121 m². Këtu parashikohet të kryhet gjelberimi me hidrombjellje në 35 m² dhe do të mbillen 306 shkurre të tipit Juniperus spp, v. 18 cm, 9 cope/m², sipas skemes së mëposhtme.

Planimetria



1234
Tirane
albania




DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT PYJOR GJIROKASTËR

d. Dalje Permet – km. 6+075

Kjo pjesë ka një sipërfaqe për të gjelbëruar me ane të hidrombjelljes prej 66 m².

e. Dalje Labove - km 12+690

Kjo pjesë ka një sipërfaqe të gjelbëruar prej 156 m². Këtu kemi mundësi zhvillimi të gjelbërimit me ane të hidrombjelljes.



f. Dalje Golem - km. 17+265

Kjo pjesë ka një sipërfaqe për t'u gjelbëruar prej 79 m². Parashikohet të kryhet hidrombjellje.

Vendndodhja



Foto te gjendjes ekzistuese



Planimetria



A handwritten signature in blue ink.


DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT PYJOR GIROKASTËR



g. Dalje Andon Poci - km. 18+350

Kjo pjesë ka një sipërfaqe për të gjelbëruar prej 175 m². Parashikohet mbjellje shkurresh te tipit Juniperus spp, 4 cope / m², gjithsej 700.



Vendndodhja



Gjendja ekzistuese



Fragment nga planimetria



h. Dalje Kardhiq - km. 20+425

Kjo pjesë ka një sipërfaqe për t'u gjelbëruar prej 137 m². Këtu kemi mundësi zhvillimi të gjelbërimit të ulët me ane të mbjelljes së shkurreve të llojit *Juniperus spp*, 18 cm të larta, 4/m².




DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT PYJOR GJIROKASTËR


Vendndodhja



Foto te gjendjes ekzistuese



Planimetria, dalja Kardhiq



i. Dalje Mashkullore - km. 23+425

Kjo pjesë ka një sipërfaqe për t'u gjelbëruar me ane të hidrombjelljes prej 74 m².



Vendndodhja





Foto te gjendjes ekzistuese




6.2. Skema teknike e mbjelljeve, planifikimi teknik i gjelbërimit të segmentit dhe krijimi i dekorit gjelbërues

Gjatësia për gjelbërim përgjatë rrugës është 30.630 ml. Punimet për gjelbërimin e këtij aksi do të realizohen në:

1. **Rehabilitimin dhe mbjelljen e skarpatave dhe bankinave me bimë drusore.** Është e nevojshme sjellja dhe shpërndarja e 408 m³ terren vegjetal për të veshur skarpatat, bankinat dhe mbeturinat e krijuara nga materialet inerte pas ndërtimit të rrugës.
 - a. Në pjesën e bankinave dhe skarpatave gjelbërimi do të kryhet nga 10 lloje drurësh: Tilia c. 18-20 cm, Celtis australis c. 18-20 cm, Carpinus betulus c. 18-20 cm, Prunus pissardi c. 18-20 cm, Fraxinus excelsior c. 18-20 cm, Cercis siliquastrum c. 18-20 cm, Liquidambar styraciflua c. 18-20 cm, Acer campestre c. 18-20 cm,.
 - b. Gjatësia totale ku do të realizohet gjelbërimi është 18.090 ml në krahun e majtë + 12.540 ml në krahun e djathtë = 30.630 ml.
 - c. Llojet drunore do të jenë të vendosura me një largësi prej 30 m nga njëra-tjetra nga aksi në aks, çfarë përkon dhe me distancën e nevojshme për shpejtësinë e lëvizjes maksimale prej 90 km/orë në këtë segment.

Te skema 8.2.1.1 paraqitet nëpërmjet seksionit tërthor se ku do të vendosen bimët drusore dhe distancat në raport me rrugën.




Skema 8.2.1.1. Seksioni tërthor i gjendjes aktuale

Te skema 8.3.1.1 paraqitet nëpërmjet fragmentit në planimetri se ku do të vendosen bimët drusore dhe distancat në raport me rrugën.



DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT PYJOR GJIROKASTËR



Fragmenti nga planimetria

2. Rehabilitimin e gjelberimit të vendqëndrimeve të përkohshme me ishuj të segmentit rrugor Tepelenë-Gjirokastër (Km.14+700-14+925; km.19+525-19+750)

Kjo tipologji ka një sipërfaqe totale për të gjelbëruar prej 220 m². Është e nevojshme sjellja dhe shpërndarja e 47 m³ terren vegjetal për bankinat dhe sipërfaqet me terren të varfër. Pasi të kryhet nivelimi me makineri të posacme të drejtuara me lazer, duhet të realizohet gjelbërimi.

Trajtimi skematik për formimin e sipërfaqeve të gjelbëra (tapetit të gjelbër), është një element tejet i rëndësishëm i këtij gjelbërimi, ku ashtu si dhe për llojet drusore, trajtimi skematik i tij do të na lejon të preventivonim saktë kostot përfundimtare të këtij projekti.

7. Segmenti Postoblok-Varrezat e qytetit, Gjirokaster, 1.3 km

Ne kete aks brenda qytetit parashikohet te kryhet gjelberimi ne te dy anet e rruges, cdo 6 m, ne trotuare, ne zone te banuar. Druret do te jene te tipit *Tilia platyphyllos*, me c. 18-20 cm. Gjithashtu parashikohet te mbillen shkurre te tipit *Nerium oleander*, cdo 1 ml, gjithsej 2,000 cope, ne vije te drejte me druret.


Parashikohet te mbillen gjithsej 429 drure, ne te dy anet e rruges, ne perputhje me planimetrine.

DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT PYJOR GIROKASTËR



Pamje nga gjendja ekzistuese e segmentit





Planimetria e segmentit Postbllok-Varrezat e qytetit, Gjirokaster

Krijimi i "Dizenjos Vizuale" përfundimtare

Gërshetimi i elementëve të gjelbërimit që trajtuam më sipër, drurë dhe sipërfaqe barishtore, për rehabilitimin e këtij segmenti, do të krijonte një pamje si më poshtë.

Ndërkaq edhe pamjet 3 dimensionale të këtij segmenti kanë një efekt viziv për të na paraqitur më së miri situatën reale që do të ndodhë në atë që është parashikuar duke krijuar pamje imagjinare me sensin e lëvizjes, dhe me llojshmërinë e bimësisë.





Panorë e Segmentit Tepelenë-Gjirokastrë pas rehabilitimit

8. Segmenti IV: Gjirokastrë- Kakavijë

Ky segment rruge është pjesë e aksit rrugor Levan - Kakavijë. Është projektuar dhe ndërtuar me 2 korsi (1 në vajtje dhe 1 në ardhje) të pandara me trafik-ndarës.




Panje e gjendjes ekzistuese




DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT PYJOR GJIROKASTËR

Relievi - Në segmentin Gjirokastër-Kakavijë mbizotëron relievi kodrinor. Lartësia mesatare mbi nivelin e detit është 400 m.

Klima - Segmenti Gjirokastër-Kakavijë ndodhet në zonën e klimës mesdhetare kodrinore me verë të nxehtë, por me rreshje më të shpeshta nga mesatarja e zaknoshme për këtë klimë. Temperatura mesatare maksimale vjetore është 20.3 gradë celsius, ndërsa temperatura mesatare minimale vjetore është 7.5 gradë Celsius. Mesatarja vjetore e rreshjeve është 1870 mm.



Grafiku tregon temperaturën mesatare mujore. Vija e kuqe tregon mesataren e temperaturës maksimale, ndërsa vija blu temperaturën minimale mesatare. Të dhënat janë bazuar në matjet gjatë dhjetë viteve të fundit.



Lartësia e kolonës blu tregon rreshjet në mm në muaj. Të dhënat janë bazuar në matjet gjatë dhjetë viteve të fundit.

Përbërja e tokës - Litologjia e kësaj zone më së shumti përfaqësohet nga tokat ranore, argjilore dhe pjesërisht nga shkëmbinjtë gëlqerore.

DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT PYJOR GJIROKASTËR

Bimësia – Segmenti Gjirokastër-Kakavijë shtrihet në një zonë të pasur me bimësi, si në lloje ashtu dhe në shtrirje. Në të ndeshen nga brezi i shkurreve gjethegjera dhe gjetherënëse që shtrihet deri në lartësinë 600-800 metra, deri teki brezi i dushkut në lartësinë 800-1200 metra.

8.1 Karakteristikat e këtij segmenti

Ky segment ka një gjatësi prej 28.965 ml. Gjerësia e korsive është 3.75 m dhe bankinë 1.5 m. Hapësirat për të implementuar gjelbërimin e lartë shkojnë në një gjerësi deri në 4 m në krah të autosradës. Këtu kemi mundësi zhvillimi të gjelbërimit të lartë duke e shtrirë përgjatë gjithë gjatësisë në të dy krahët e rrugës me 10 lloje të ndryshme pemësh, si dhe kemi mundësi të rehabilitojmë skarpatat dhe bankinat. Seksioni tërthor na tregon gjendjen aktuale.



Skema 10.1.1. Seksioni tërthor i gjendjes aktuale

Punimet për gjelbërimin e këtij aksi do të realizohen në:

1. Rehabilitimin dhe mbjelljen e skarpatave dhe bankinave me bimë drusore. Është e nevojshme sjellja dhe shpërndarja e 23,232 m³ terren vegjtal për të veshur bankinat dhe skarpatat e krijuara nga materialet inerte pas ndërtimit të rrugës. Do të kryhet nivelimi me makineri të posacme të drejtuara me lazer, si dhe mbjellja me bimësi drusore me distancë 30 ml nga aksi në aks.

- a. Për të krijuar më mirë imazhin e gjelbërimit, për të lehtësuar punën, kryer preventivimin e punimeve dhe për të llogaritur kostot përfundimtare që duhen për të gjelbëruar këtë segment do të përdoren rëndërat e rehabilitimit. Në të njëjtën kohë ajo shërben për të orientuar saktë sipërmarrësit e punimeve për të kryer punime të sakta dhe për të arritur versionin përfundimtar të gjelbërimit. Në planimetritë me progresiva nuk janë paraqitur zona nga km.0+000 – 5+465, ku nuk do të ndërhyet me gjelbërim.



DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT PYJOR GJIROKASTËR

- b. Aty tregohet gjithashtu mënyra e vendosjes së bimëve në formë drunore me distanca të përcaktuara. Llojet drunore do të jenë të vendosura me një largësi prej 30 m nga njëra-tjetra nga aksi në aks, çfarë përkon dhe me distancën e nevojshme për shpejtësinë e lëvizjes maksimale prej 90 km/orë në këtë segment.
- c. Trajtimi skematik për formimin e sipërfaqeve të gjelbëra (tapetit të gjelbër), është një tjetër element i rëndësishëm i këtij gjelbërimit, ku ashtu si dhe për llojet drusore, trajtimi skematik i tij do të na lejojte të preventivonim saktë kostot përfundimtare të këtij projekti.

1. Rehabilitimin e gjelbërimit të vendqëndrimeve të përkohshme me ishuj të segmentit rrugor Gjirokastrë-Kakavijë (km 12+835-13+015, km 19+225-19+365, km 20+565-20+690)


Kjo tipologji ka një sipërfaqe totale për të gjelbëruar prej 340 m². Këtu kemi mundësi zhvillimi të gjelbërimit të ulët. Është e nevojshme sjellja dhe shpërndarja e 80 m³ terren vegjetal për sipërfaqet me terren të varfër.

2. Rehabilitimin e gjelbërimit në Hyrje-Daljet e qendrave të banuara

Në hyrje-daljet e qendrave të banuara të këtij segmenti ka mundësi të zhvillohet gjelbërimit me anë të tapetit të barit, ose shkurreve, sipas rastit. Gjelbërimit do të realizohet në hyrje-daljet e specifikuar si më poshtë:

a. Dalje Dervican (km 6+815)

Kjo pjesë ka një sipërfaqe të gjelbëruar prej 96 m². Këtu mund të kryhet gjelbërimit me anë të hidrombjelljes.



b. Dalje Goranxi (km 8+640)

DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT PYJOR GIROKASTËR

Kjo pjesë ka një sipërfaqe të gjelbëruar prej 66 m². Ketu mund te kryhet gjelberimi me ane te hidrombjelljes


Vendndodhja




Foto te gjendjes ekzistuese



Fragment nga planimetria



DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT PYJOR GJIROKASTËR



c. Dalje Vanistër (km 9+680)

Kjo pjesë ka një sipërfaqe të gjelbëruar prej 73 m^2 . Ketu mund te kryhet gjelberimi me ane te hidrombjelljes.



d. Dalje Sofratikë (km 11+965)


Kjo pjesë ka një sipërfaqe të gjelbëruar prej 76 m^2 . Ketu mund te kryhet gjelberimi me ane te hidrombjelljes, si dhe vendosje e shkurreve te tipit *Juniperus spp*, V. 18 cm, ne trekendeshat e vegjel, $9/\text{m}^2$.


DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT PYJOR GIROKASTËR

Vendndodhja




Foto te gjendjes ekzistuese





e. Dalje Terihat (km 13+515)

Kjo pjesë ka një sipërfaqe të gjelbëruar prej 80 m². Ketu mund të kryhet gjelberimi me ane të hidrombjelljes.



f. Dalje Frashtan (km 15+915)

Kjo pjesë ka një sipërfaqe të gjelbëruar prej 178 m². Ketu mund të kryhet gjelberimi me ane të hidrombjelljes.




g. Dalje Grapsh (km 18+015)

Kjo pjesë ka një sipërfaqe të gjelbëruar prej 194 m² , Ketu mund te kryhet gjelberimi me ane te hidrombjelljes.



DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT PYJOR GJIROKASTËR



h. Dalje Jorgucat (km 19+590)

Kjo pjesë ka një sipërfaqe të gjelbëruar prej 354 m². Ketu mund të kryhet gjelberimi me ane të hidrombjelljes.



DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT PYJOR GIROKASTËR


i. Dalje Zervat (km 23+115)

Kjo pjesë ka një sipërfaqe të gjelbëruar prej 105 m². Këtu mund të kryhet gjelberimi me ane të hidrombjelljes.

Vendndodhja



Foto të gjelbësjes ekzistuese




j. Dalje Vrisera (km 26+815)

Kjo pjesë ka një sipërfaqe të gjelbëruar prej 176 m². Këtu mund të kryhet gjelberimi me anë të hidrombjelljes.

Vendndodhja



Foto të gjendjes ekzistuese




k. Dalje Drite (km 28+315)

Kjo pjesë ka një sipërfaqe të gjelbëruar prej 116 m². Ketu mund te kryhet gjelberimi me ane te hidrombjelljes.

Vendndodhja



Foto te gjardjes ekzistuese




DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT PYJOR GJIROKASTËR

8.1.1. Skema teknike e mbjelljeve, planifikimi teknik i gjelbërimit të segmentit dhe krijimi i dekorit gjelbërues

Gjatësia totale ku do të realizohet gjelbërimi është 21.660 ml në krahun e majtë + 21.390 ml në krahun e djathtë = 43.050 ml. Punimet për gjelbërimin e këtij aksi do të realizohen në:

1. **Rehabilitimin dhe mbjelljen e skarpatave dhe bankinave, mbjellja e bimeve drusore.** Është e nevojshme sjellja dhe shpërndarja e 23,232 m³ terren vegjetal për të veshur skarpatat, bankinat dhe mbeturinat e krijuara nga materialet inerte pas ndërtimit të rrugës. Kryhet nivelimi me makineri të posacme të drejtuara me lazer.
